



# Zëri i gruas te ata që janë të huaj për të

الحمد لله و صلى الله و سلم على نبينا محمد : أما بعد

**Nuk ka argument që e ndalon gruan të flasë dhe të dëgjohej zëri i saj te ata që nuk i ka të afërm (mahrem).**

Thotë Ibn Haxheri në [Fethul Bari]:

*"Në këtë hadith ka argument se zëri i gruas lejohet të dëgjohej." -F-*

Thotë Bin Bazi:

*"Zëri i gruas nuk është Auret (gjë e turpshme/e ndaluar).*

*Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem ka dëgjuar zërin e grave, po ashtu edhe shokët e tij kanë dëgjuar zërin e tyre." -F-*

[El Fetawa El Bazijjeh]

Thotë Bin Bazi:

*"I lejohet gruas të pyesë (atë që nuk e ka të afërm) për nevojat e saj, të shes apo të blejë." -F-*

[El Fetawa El Bazijjeh]

Dmth përderisa i lejohet të shesë dhe të blejë, atëherë lejohet t'a dëgjojnë zërin e saj burrat e huaj, sepse ajo do e pyesë sa kushton malli etj.

Thotë Shejkh Albani:

*"Zëri i gruas te burrat është si zëri i burrave te gratë. Nuk ka dallim. Zëri këtu është për qëllim zëri normal i saj.*

*Ama nëse e zbut zërin e saj dhe e zbukuron atë, në këtë rast është e ndaluar." -F-*

[Fetewa abral Hatif ue Sejjarah, kaseta 246]

Thotë shejkh Ibn Utthejmini:

*"Nuk ka problem që t'a dëgjoje burri zërin e gruas (që nuk e ka të afërm), por pa e zbutur dhe holluar zërin." -F-*

Thotë LEXHNJA (komisioni i përhershëm):

*"Zëri i gruas nuk është auret dhe nuk është i ndaluar të dëgjohej." -F-*

[Fetava El-lexhneh 17/202]

Pra, zëri i gruas nuk është aures dhe nuk është i ndaluar të dëgjohet nga burrat që janë të huaj për të.  
Të flase gruaja (me të folurin e saj normal, me zërin e saj normal, pa e zbutur) në prezencë të ndonjë burri të huaj, apo të pyes një burrë për diçka, nuk ka problem.

Ajo ç'farë ndalohej është:

Zbuturimi i zërit dhe hollimi i zërit me qëllim.  
Kjo është ajo që ka ndaluar All-llahu -سبحانه-.

Thotë All-llahu (duke iu drejtuar grave të Profetit, dhe bashkë me to edhe grave tjera):

( فلا تخضعن بالقول )

Kuptimi:

{Mos e holloni dhe zbutni zërin kur të flitni}

Dmth: mos e zbuturoni.

Pra, ajo që ndalohej është zbuturimi i zërit dhe jo vetë zëri.

Zbuturimi i zërit dhe hollimi i zërit me qëllim nuk bën, qoftë edhe nëse e zbutur duke lexuar Kur'an me zë në prezencë të ndonjë burri të huaj.

U pyet Shejkh Albani:

*"A i lejohet gruas të lexojë Kur'an para një mësuesi, që t'a mësojë dhe korrigjojë kur ajo gabon?"*

*Shejkh u përgjigj: Nuk lejohet kjo gjë."* -F-

Në një vend tjetër Shejkh Albani thotë:

*"Nëse e lexon me zë normal pa texhuid (dmth: e lexon pa këndim, thjeshtë, sikur lexon një hadith), në këtë rast, nëse nuk bën fitne ndoshta lejohet.*

*Por unë nuk e di. Ato e dinë nëse bëjnë fitne apo jo.*

*Pyetësi i tha: Fitnja është prezente në çdo lloj forme.*

*Shejkh u tha: Atëherë është e ndaluar."* -F-

[Silsile Huda ue Nur 814]

Ibn Uttejmini thotë:

*"Nëse e lexon në formë këndimi me texhuid nuk lejohet. E nëse e lexon pa këndim (dmth: thjeshtë sikur lexon një hadith) lejohet."*

Shejkh Feuzani thotë:

*"Nuk lejohet që gruaja të lexojë Kur'an me zë në prezencë të burrave të huaj.*

*Prandaj kur ajo falet me xhemat me burrat nuk i lejohet të ngrejë zërin kur thotë Amin, apo t'a korrigjojë imamin me zë etj.."* -F-

All-llahu e di më së miri.

Ai është më i dijsmi.

-----

والحمد لله رب العالمين

و صلى الله على نبينا محمد وعلى آله وصحبه وسلم